

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“D-POWER” sh.p.k**

Sot ,me date **18.01. 2024** (dymije e njezetekater) i pranishem:

Z.Kastriot Dermynshi, shtetas Shqiptar, lindur më 31.12.1969 në Gramsh, banues ne Durres me numer ID. G91231036R , i cili ne cilesine e ortakut themelues shpall hartimin dhe nenshkrimin e ketij Akt Themelimi në përputhje me ligjisionin shqiptar dhe me termat si me poshtë vijon:

**KAPITULLI I**

**EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI**

**NENI 1**

**EMERTIMI**

- 1.1. Themelohet nje shoqeri e se drejtes shqiptare me pergjigjesi te kufizuar me emertimin  
“D-POWER” sh.p.k
- 1.2. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

**NENI 2**

**SELIA**

2.1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën rruga “Miqesia”, pasuria nr. 104/14, Zona kadastrale 8517, Durres, Shqiperi. Asembleja Ortakëve mund të vendose krijimin ose mbyljen e selive dytësore, filialeve, zyrave të perfaqesimit dhe degëve të shoqerisë ose transferimin e selisë së shoqerisë në qytete të tjera si në Shqipeëri ashtu edhe jashtë saj.

**NENI 3**

**KOHEZGJATJA**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit të shoqerisë në Regjistrin e Shoqërive Tregtare deri sa te mbyllet me akte ligjore.



## NENI 4

### OBJEKTI

#### 4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmese. Përfshirë dhe pa u kushtëzuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, institucionet përgjegjëse shtetërore (qofshin këto organe Qendrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtë vendit

Prodhim dhe shitje energjie elektrike nga panelet diellore, hidrocentralet dhe era. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.

Transporti, shitja dhe tregtimi i instalimeve fotovoltaike, termike dhe për kursimin e energjisë. Tregtim me pakicë dhe shumicë të benzines, naftës, gazit, lubrifikanteve dhe të gjithë produkteve dhe nënprodukteve të tyre.

Prodhim konstruksione metalike të llojeve të ndryshme, ndertimi të ndryshme civile dhe industriale me konstruksione metalike.

## KAPITULLI II

### KAPITALI THEMELTAR

#### NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100'000 lekë (njqind mije lekë) i përbërë nga 1(nje) kuote.

z. Kastriot Dermyshe zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë në vlerë 100'000 lekë (Njqindmije lekë).

Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të asamblesë së ortakëve themelues. Kuota e Pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha të emruara dhe të pa ndashme. Kapitali është teresisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

#### NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe organi administrativ. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është organi vendimarrës i shoqërisë dhe vepron në përputhje me statutin e shoqërisë dhe ligjet në fliqi. Organi i vetëm Administrativ i shoqërisë është Administratori i saj i vetëm,



- Z. Kastriot Dermyshe, shtetas shqiptar, lindur me 31.12.1969 ne Gramsh e banues në Durës, Rr.Pireu me numer personal ID. G91231036R

Administratori ka të gjitha kompetencat per administrimin e zakonshem të shoqerise, në përputhje me sa parashikohet nga ligji. nga akti i themelimit dhe nga statuti i shoqërisë. Administratori ka të drejta dhe kompetenca të plota per kryerjen e të gjitha veprimeve që do të konsideroje të dobishme per realizimin e objektivave të shoqërisë, me përjashtim të atyre që kërkojnë miratimin paraprak të Asamblesë se Pergjithshme. Administratori perfaqeson shoqerinë në marrëdhënie me të tretët, përpara organeve shtetërore dhe private.

#### NENI 7

#### PJESMARRJA NE SHOQERI TE TJERA

Ortakët mund te vendosin lirishi pjesemarijen në shoqeri të tjera si dhe të fllojnë cdo lloj aktiviteti tjetër tregtar në territorin e Shqipërisë, me kushtin që të mos jetë konkruues me ate te shoqërisë së themeluar prej tyre. Cdo veprimtari qe bie ndesh me paragrafin e siperpermendur nuk do te konsiderohet si konflikt interesi nese mer votbesimin e të paktën 51% (pesedhete e një perqind) te ortakeve.

#### NENI 8

#### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e shoqerise do të rreguilohet nga dispozitat e statutit të shoqerise, Si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore ne fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### NENI 9

#### ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarreveshjet që mund të lindin ne te ardhmen ndërmjet ortakeve ose ndërmjet ortakeve dhe shoqerise dhe që ka lidhje me të drejta ë disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqerine do t'i drejtohen për zgjidhje si fillim me marrveshje mes palëve ose në të kundert në Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### NENI 10

#### DISPOZITA FINALE

Ky akt themelimi u hartua në kater njësi të barazvlefshme e njejta në gjuhen shqipe, nga ortaku i shoqerise, i cili njekohesisht autorizon depozitimin e ketij Akti Themelimi dhe Statutit te Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

#### Hyrja ne fuqi

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaket.

#### ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“ D-POWER “ sh.p.k.

Kastriot Dermyshe